



|                                                                  |         |                  |
|------------------------------------------------------------------|---------|------------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO      |         |                  |
| KOMUNA E PODUJEVËS / OPŠTINA PODUJEVO / MUNICIPALITY OF PODUJEVA |         |                  |
| DREJTORIA E ADMINISTRATËS - UPRAVA ADMINISTRACIJE                |         |                  |
| Dërguar më 24.08.2026                                            |         |                  |
| Nifsh origj.                                                     | Nr. Br. | Shtojcë - Prilog |
| Org. ledi.                                                       |         |                  |
| 15-300/p1-0051956/26                                             |         |                  |
| PODUJEVË - PODUJEVO                                              |         |                  |



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva

## DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK

Bazuar në nenin 62.3 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenin 64 par.3 dhe 4 të statutit të Komunës nr.01-020/01-50862/18, nenin 18.3 të rregullores për kushtet/kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr.prot: 01-016/01-0030667/22 dhe bazuar në planin e punës dhe në buxhetin për vitin 2026, Drejtoria për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik shpall:

### FTESE PUBLIKE

për aplikim në projektin:

### SUBVENCIONIMI I BIZNESEVE DHE NDËRRMARRJEVE PUBLIKE

(Mbështetje me pajisje pune)



Aparat saldimiti CO2, rryma e saldimit: 30 - 250A  
diametri i telit të saldimit: Ø 0.6 - 1.2mm



Kompresor 500L, kw 5.5



Ngritës me kriket për vetura 4000kg – lift



Makinë për balancim të gomave





*Makina profesionale për shtypjen e nxehtë  
semi automatike, multicolor*



*Hekur për hekurosje profesionale  
me avull 3.5L*



*Makina qepëse industriale Iberdek*



*Makina qepëse industriale Overlluk*






*Makina qepëse industriale e drejtë*



*Frigorifer për ftohje/ventilim, 700L, 800wat  
me xhama Inox*



*Mikser për brum, min 10kg*



*Furrë për pjekje me avull, 73 L, 4 tepsia, 50 kg*





### Të drejtë aplikimi kanë:

- Banorë të Komunës së Podujevës – Biznese ekzistuese dhe Start up.

### Kushtet për aplikim:

- Biznesi veprimtarinë ta ushtrojë në territorin e Komunës së Podujevës.
- Të mos ketë obligime financiare të papaguara ndaj Komunës dhe ATK-së.

### **1) BIZNESET EKZISTUESE**

#### Dokumentet e nevojshme për të aplikuar janë:

- 1) Aplikacioni
- 2) Kopjen e letërnjoftimit të aplikuesit *(në emër të cilit është i regjistruar biznesi)*
- 3) Deklaratë/Çertifikatë e bashkësisë familjare
- 4) Certifikatën e biznesit me informatat e biznesit *(jo më e vjetër se 3 muaj)*
- 5) Vërtetimin e tatimit në pronë *(dëshmi për pagesën e tatimit)*
- 6) Vërtetimin tatimor nga ATK *(dëshmi për pagesën e obligimeve)*
- 7) Deklaratën për bashkëfinancim 30%

#### Forma e vlerësimit:

| Kriteret                                                                                                                                     | Poena       |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|
| 1 Forma e aplikimit - Projekt propozimi;                                                                                                     | <b>0-30</b> |
| 2 Vizita në teren;                                                                                                                           | <b>0-30</b> |
| 3 Dëshmi për përvojë në veprimtarinë aplikuese (Certifikatë/Vërtetim);                                                                       | <b>15</b>   |
| 4 Biznes në pronësi të Gruas                                                                                                                 | <b>15</b>   |
| 5 Aplikues/e (biznese) që nuk kanë përfituar më parë nga ndonjë projekt, thirrje apo ftesë publike të Komunës në vitet (2024,2025 dhe 2026). | <b>10</b>   |

### **2) START UP**

#### Dokumentet e nevojshme për të aplikuar janë:

- 1) Aplikacioni
- 2) Kopjen e letërnjoftimit të aplikuesit
- 3) Deklaratë/Çertifikatë e bashkësisë familjare
- 4) Vërtetimin e Tatimit në pronë *(dëshmi për pagesën e tatimit)*
- 5) Deklaratën për bashkëfinancim 30%



### Forma e vlerësimit:

| Kriteret                                                                                                                                     | Poena |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------|
| 1 Forma e aplikimit - Projekt propozimi                                                                                                      | 0-30  |
| 2 Vizita në teren;                                                                                                                           | 0-30  |
| 3 Dëshmi për përvojë në veprimtarinë aplikuese (Certifikatë/Vërtetim);                                                                       | 15    |
| 4 Aplikuese Grua                                                                                                                             | 15    |
| 5 Aplikues/e (familje) që nuk kanë përfituar më parë nga ndonjë projekt, thirrje apo ftesë publike të Komunës në vitet (2024,2025 dhe 2026). | 10    |

Aplikimi fillon me datë **24.08.2026** dhe mbaron **11.09.2026**. Aplikacioni mund të merret pranë Drejtorisë për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik, nr.45 dhe të dorëzohen në Zyrën e Shërbimit të Qytetarëve në Komunën e Podujevës.

### VËREJTJE:

- Një aplikant nuk mund të dorëzoj më shumë se një aplikacion në këtë thirrje publike, por në një aplikim mund të bëjë kërkesë për tre (3) pajisje nga pakoja e përgjithshme e ofruar e pajisjeve. (Në kuptimin e kësaj thirrje, seti llogaritet një (1) pajisje)
- Për Start-Up aplikimi duhet të bëhet nga personat të cilët synojnë të fillojnë biznesin, jo nga persona të tjerë në emër të tyre dhe pas shpalljes si përfitues duhet regjistruar biznesin.
- Për Biznese ekzistuese aplikimi duhet të bëhet nga pronarët/aksionarët e bizneseve siç figurojnë në certifikatën e ARBK-së apo të autorizuarit e tyre.
- Përfituesit do të marrin pjesë (participim) me 30% të vlerës së projektit.
- Personi fizik apo juridik vetëm një herë në vit mund të jetë përfitues i subvencioneve të ndara nga komuna. (*neni 6.2 i rregullores së subvencioneve*)
- Në bazë të numrit të përgjithshëm të aplikacioneve të pranuara, komisioni gëzon të drejtën të vendos për të subvencionuar bizneset me një, dy apo tri pajisje nga pakoja e përgjithshme e ofruar.
- Gjatë shqyrtimit të aplikacioneve do të verifikohet nëse aplikuesi, pronari i biznesit apo ndonjë nga familjarët e tyre ka qenë përfitues gjatë viteve 2024, 2025 dhe 2026 nga ndonjë projekt, thirrje apo ftesë publike e Komunës. Në varësi të numrit të përgjithshëm të aplikimeve të pranuara, Komisioni gëzon të drejtën të vendos nëse aplikacionet e tilla do të vazhdojnë në procesin e shqyrtimit dhe nëse do të realizohet vizitë në terren.
- Dokumentacioni i pakompletuar dhe i dorëzuar pas afatit kohor nuk do të shqyrtohet.

Drejtori i DPZHE

*z. Vigan Salihu*

